

TERMA REFERENCE



Për Objektin:

“BLERJE E PAJISJEVE TE MOBILIMI NE UNIVERSITETIN E MJEKESISE, TIRANE”

Objektivi i këtij investimi është pajisja me mobilim i disa ambienteve të sapo rikonstruara në Universitetin e Mjekësisë si në vijim:

Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Fakultetin e Mjekësisë Dentare dhe në ambientet e zyrave të Rektoratit të këtij Universiteti.

Duke ju referuar kërkesave të ardhura nga këto fakultete si dhe projekteve të zbatimit për rikonstrukcionin e pjesshëm të tyre, i cili ka përfunduar, u bë shqyrtimi në vend i kapaciteteve dhe nevojave në hapsirat e propozuara për mobilim. Gjithashtu, për të patur një studim sa më optimal dhe një produkt të qëndrueshëm dhe cilësor, pajisjet e mobilimit që parashikohen të përftoheshin, u grupuan në disa kategori, gjë që evidentohet në vijim të këtij materiali.

Hapat që janë ndjekur për hartimin e termave të referencës dhe specifikimet teknike janë:

1. Njohja me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të përmasave optimale të mobilimit të hapsirave publike me karakter social-shoqëror
2. Azhornimi dhe matja e sipërfaqeve që do të mobilohen
3. Njohja me kërkesat dhe nevojat konkrete të Fakulteteve dhe Institucioneve në të cilat përfshihen hapsirat që do të mobilohen
4. Përcaktimi i listës së pajisjeve të mobilimit duke hartuar paralelisht dhe pozicionimin e tyre në hapsirat përkatëse
5. Përcaktimi i përmasave optimale të mobiljeve, referuar kjo edhe volumeve ekzistuese të ambienteve si dhe standartet e dimensionimit të hapsirave midis tyre
6. Hartimi i specifikimeve teknike për secilën pajisje mobilimi, duke u përpjekur për të respektuar standartet optimale dhe një cilësi shumë të mirë. Kjo, referuar edhe karakterit specifik që kanë hapsirat që do të mobilohen
7. Hartimi i listës së plotë të pajisjeve të mobilimit dhe sasi të përkatëse, të specifikuara edhe sipas pozicionimit
8. Përcaktimi i cmimeve njësi dhe fondit limit për investimin e mobilimit, nëpërmjet studimit të ofertave të tregut duke shpërndarë listën e pajisjeve të mobilimit dhe sasi të tyre

Njohja me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të përmasave optimale të mobilimit të hapsirave publike me karakter social-shoqëror

Për sa i përket përmasimit të mobiljeve, si dhe dimensionet midis orendive, një ndihmesë të rëndësishme ka dhënë Udhëzuesi për Projektimin e Ndërtesave Shkollore, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Gjithashtu, për të patur standarte optimale për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, jemi mbështetur në Udhëzuesin përkatës të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Azhornimi dhe matja e sipërfaqeve që do të mobilohen

Për sa i përket azhornimit të sipërfaqeve për mobilim, në fillim u bë njohja me projektet e zbatimit për rikonstrukcionin e këtyre hapsirave dhe më pas verifikimi i përmasave në vend. Më pas u hartua planimetria përkatëse për çdo ambient. Hapsirat që propozohen të mobilohen janë si në vijim:

- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka si objekt të mobilimit, hapsirat e reja të krijuara në hollin e katit përdhe me funksion si reception, sekretari, magazinë dhe zyra, si dhe zyra e dekanit të fakultetit, që ndodhet në katin e parë.

- Fakulteti i Mjekësisë ka si objekt të mobilimit sallën e leksioneve tip auditor, e cila ndodhet në katin përdhe të godinës së Departamentit të Mjekut të Familjes . Gjithashtu janë për tu kompletuar me mobilim edhe dy zyrat e zëvendësrektorëve dhe ajo e kancelarit të këtij fakulteti, të cilat ndodhen në katin përdhe të godinës së Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë
- Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, ka si objekt të mobilimit zyrat e punonjësve të administratës, arkivën dhe zyrën e protokollit në katin e parë të godinës
- Fakulteti i Mjekësisë Dentare ka për objekt të mobilimit ambientet e sekretarisë mësimore, në hollin e katit përdhe, sallën e leksioneve, sallën e specializantëve dhe arkiven

Njohja me kërkesat dhe nevojat konkrete të Fakulteteve dhe Institucioneve të cilat përfshijnë hapsirat që do të mobilohen

Referuar hapit të tretë që ka të bëjë me njohjen kërkesat dhe nevojat konkrete të këtyre institucioneve, është bërë takim me administratorët përkatës, ku është diskutuar mbi funksionin dhe specifikat e hapsirave që duhet të mobilohen . Gjithashtu, si rrjedhojë e kërkesave të përsëritura të këtyre fakulteteve për tu pajisur me mobilimin përkatës, është çelur edhe zëri i investimit për secilin fakultet, në Buxhetin e plotë të Universitetit të Mjekësisë për vitin kalendarik 2016, referuar Vendimit Nr.8, datë 14.04.2016, me nr.6/5 Prot. Dt 14.04.2016, me objekt “Për miratimin e plotë të Buxhetit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për vitin kalendarik 2016”.

Domosdoshmërinë për kryerjen e këtij investimi, e thekson edhe më shumë fakti i përfundimit të rikonstruksioneve të pjesëshme të disa prej këtyre ambienteve. Më saktësisht, ka përfunduar rikonstruksionin e pjesëshëm Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare. Ndërsa është në proces rikonstruksioni pjesor edhe Fakulteti i Mjekësisë, që sipas kontratës së punimeve me subjektin ndërtues, i përfundon këto punime në javën e tretë të muajit nëntor 2016.

Përcaktimi i listës së pajisjeve të mobilimit duke hartuar paralelisht dhe pozicionimin e tyre në hapsirat përkatëse

Duke u mbështetur tek projektet e zbatimit të rikonstruksionit të hapsirave, si dhe në kërkesat e personave përgjegjës, u hartua edhe lista e pajisjeve të mobilimit e cila është menduar të ndahet në disa grupime. Në grupimin e parë, atë të karrigeve, përfshihen stolat me tre ulëse për holl, karriget-poltrona për vend pune drejtuesi, karriget-poltrona për vend pune specialisti, karrige për tavolinë mbledhjeje, karrige të thjeshta, poltrona e pa inkastruar me syprinë të inkuorporuar për auditorin, poltrona e inkastruar me syprinë të inkuorporuar për auditorin si dhe poltrona dyshe. Në grupimin e dytë, atë të tavolinave, përfshihen dy lloj tavolinash pune për specialistë, dy lloj tavolinash me kënd për drejtues, dy lloj tavolinash për mbledhje, tavolinë për katedër dhe foltorja përkatëse, si dhe tavolinë ngrënieje dhe tavolinë mesi për dhomë stafi. Në grupimin e tretë, atë të komodinave bëjnë pjesë komodinat me tre sirtare dhe karrocet tip karrel. Në grupimin e katërt bëjnë pjesë dy mobiljet e kuzhinës për dhomën e stafit. Në grupimin e pestë, atë të bibliotekave bëjnë pjesë bibliotekat etazher, raftet me elementë të hapur dhe raftet me elementë gjysëm të hapur, raftet metalike të hapur dhe me kanate. Në grupin e gjashtë, bëjnë pjesë receptionet me një post pune dhe me tre poste pune. Ndërsa në grupin e fundit, atë të aksesoreve, bëjnë pjesë varëset e rrobave tip “prift” dhe tabela e zezë e shkrimit.

Përcaktimi i përmasave optimale të mobiljeve, referuar kjo edhe volumeve ekzistuese të ambienteve si dhe standartet e dimensionimit të hapsiraveve midis tyre

Referuar standarteve kombëtare të projektimit si dhe normave që rrjedhin nga vendimet apo aktet administrative të sipërpërmendura, si dhe duke ju referuar edhe përmasave të ambienteve që do të

mobilohe, është bërë edhe pozicionimi në planimetri i pajisjeve të mobilimit. Nëpërmjet orjentimit të pajisjeve në planimetri, ka dalë i përlogaritur edhe numri përkatës për secilin lloj. Është marrë parasysh në këtë fazë, që mobiljet (sidomos bibliotekat) duhet të kenë përmasa optimale për të bërë të mundur transportimin e lehtë të tyre, duke shmangur dëmtimet e mundshme. Gjithashtu është patur parasysh që të lihen midis orendive edhe hapsirat optimale, për të bërë të mundur lëvizjen pa vështirësi të stafit.

Hartimi i specifikimeve teknike për secilën pajisje mobilimi, duke u përpjekur për të respektuar standartet optimale dhe një cilësi shumë të mirë.

Duke ndjekur rrjedhën llogjike të projektimit, janë hartuar edhe specifikimet teknike për çdo pajisje. Në vijim janë dhënë të plota këto specifikime, të cilat jo vetëm që përshkruajnë fizikisht pajisjen, por japin edhe përmasat optimale të tyre, referuar vendit të montimit.

1. F.Stol metalik për pritje në holl:

Stoli metalik për pritje në holl, duhet të jetë i përbërë nga 3 karrige të lidhura bashkë ose të fiksuara në një strukturë metalike solide, e lyer me ngjyrë metalike nëpërmjet procesit elektrostatik . Përmasat e mobiljes duhet të jenë jo më të vogla se (150x42x46cm). Ndenjëset dhe shpinoret duhet të jenë me material rramarinë e brimëzuar dhe e lyer me ngjyrë metalike nëpërmjet procesit elektrostatik. Ato gjithashtu duhet të jenë rezistente ndaj deformimit, gërvishtjeve dhe të kenë formë të kurbëzuar sipas formave të trupit në vendet e mbështetjes. Në vendet e takimit me trupin mund të kenë edhe një shtresë amortizuese e cila mund të jetë me material rezistent dhe lehtësisht e pastrueshme. Struktura metalike duhet të jetë solide ndaj deformimeve dhe e kromuar. Mbështetja me tokën duhet të bëhet me tako plastike të regjistrueshme, për të mbrojtur strukturën nga lagështira.

2. F.Karrige - Poltronë për vend pune drejtuesi:

Kjo karrige duhet të jetë e rrotullueshme, me bazament prej materiali metal i kromuar, me 5 rrota cilësore, me material antizhurmë dhe antigërvishtje.

Ulësja dhe mbështetësja duhet të jenë një trup i pandashëm, me strukturë të pa deformueshme, e mbushur me material amortizues dhe të jetë e mbuluar me tapiceri lëkurë ekologjike, rezistente, antibakterial, i padepërtueshëm nga uji dhe praktik ndaj procesit të larjes. Përmasat e poltronit duhet të jenë jo më të vogla se: Shpinorja 80x50cm dhe ulësja 40x50cm. Lartësia e ulëses së karriges duhet të jetë e rregullueshme nëpërmjet një pistoni ulje-ngritjeje. Shpinorja e karriges duhet të ketë një formë të tillë që të ofrojë qëndrim dhe përshtatje optimale. Ajo duhet të jetë e rregullueshme në këndin e pjerrësisë së mbështetjes. Mbështetëset e krahëve duhet të jenë të përbëra nga strukturë metalike të veshura me material amortizues dhe rezistent ndaj fërkimit.

3. F.Karrige-Poltronë për vend pune specialisti:

Karrige me krahë, e lëvizshme, me 5 rrota me bazën plastike të zezë, pjesa mbështetëse ka fleksibilitetin e duhur për tu mbështetur, komfote, e veshur me material rezistent, antibakterial, e padepërtueshme nga uji dhe praktik ndaj procesit të larjes. Lartësia e ulëses së karriges duhet të jetë e rregullueshme nëpërmjet një pistoni ulje-ngritjeje. Mbështetëset e krahëve duhet të jenë të përbëra nga strukturë plastike të veshura me material amortizues dhe rezistent ndaj fërkimit. (pesha rreth 12kg, lartësia e shpinores jo më e vogël se 90/107cm, lartësia e ndenjësës jo më të vogël se 45/52cm, thellësia jo më e vogël se 44cm, gjerësia jo më e vogël se 50cm.)

4. F.Karrige për tavolinë mbledhjeje :

Kjo karrige përbëhet nga një strukturë metalike të kromuar, me seksion tërthor oval i kurbuar. Ky skelet duhet të ketë formë të tillë në mënyrë që të baletosen (futen njëra në tjetrën për mundësi transporti). Fundi i këmbëve dhe anësoret e tyre duhet të mbulohe me tapa në mënyrë që të shmangin

gërvishtjet e ndyshme. Këndi mbështetës duhet të jetë jo më i madh se 105° , për të formuar një qëndrim ergonomik ulëses dhe mbështetëses. Kjo strukturë duhet të bëjë të mundur edhe mbështetjen e duarve. Ulësja dhe mbështetësja duhet të kenë formë të harkuara dhe ergonomike për qëndrimin sa më të rehatshëm. Ato duhet të kenë fleksibilitetin e duhur për tu mbështetur, komferte, të veshura me material rezistent, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe praktik ndaj procesit të larjes.

5. F.Karrige e thjeshtë :

Karrige e thjeshtë, konferte, e kornizuar me 4 këmbë metalike të palëvizshme me tapa plastike. Ulësja dhe mbështetësja duhet të jenë të veshura me material rezistent, antibakterial, i padepërtushëm nga uji dhe praktik ndaj procesit të larjes. (pesha 7kg, lartësia e shpinores jo më e vogël se 82cm, lartësia e ndenjësës jo më e vogël se 45cm, thellësia rreth 43cm, gjerësia rreth 43cm.)

6. F.V. Poltronë për auditor:

Kjo poltronë do të shërbejë për të mobiluar auditorin e leksioneve, i cili ka formë ovale dhe sipërfaqe të shkallëzuar, duke bërë që nga rreshti në rresht të ketë një disnivel optimal për të mospenguar rrezen e shikimit. Këto poltrona, të vendosura në rresht njëra përbri tjetrës, do jenë të fiksuara në tokë sipas linjës që krijojnë shkallët. Poltrona do të ketë strukturë metalike, mbështetëse statike, ndenjëse të palosshme në aksin e brinjës, dhe një mbështetëse për krahun e djathtë e cila do të ketë bashkëlidhur edhe një syprinë për të mundësuar mbajtjen e shënimeve nga studentët. Kjo syprinë duhet të jetë e rrotullueshme rreth dy akseve në mënyrë që të mundësojë frekuentimin e poltronës. Aksesorët që mundësojnë lëvizjen dhe rrotullimi e kësaj syprine, duhet të jenë tepër cilësorë. Mbështetësja dhe ndenjësja duhet të jenë të veshura me material amortizues dhe të jenë të mbuluara me material rezistent, antibakterial, i padepërtushëm nga uji dhe praktik ndaj procesit të larjes. Lartësia e poltronit duhet të jetë jo më të vogla se: Shpinorja 90 cm dhe ulësja 45 cm. Karriget duhet të kenë mundësi bashkimi sipas vendit dhe gjatësisë në rreshta.

7. F.V. Karrige për auditor:

Kjo karrige do të shërbejë për të mobiluar auditorin e leksioneve, i cili ka sipërfaqe të dyshemesë të shkallëzuar, duke bërë që nga rreshti në rresht të ketë një disnivel optimal për të mospenguar rrezen e shikimit. Karrigia do të ketë strukturë metalike, mbështetëse dhe ndenjëse statike dhe dy mbështetëse për krahët, ana e djathtë e të cilave duhet të ketë bashkëlidhur edhe një syprinë për të mundësuar mbajtjen e shënimeve nga studentët. Kjo syprinë duhet të jetë e rrotullueshme rreth dy akseve në mënyrë që të mundësojë frekuentimin e poltronës. Aksesorët që mundësojnë lëvizjen dhe rrotullimi e kësaj syprine, duhet të jenë tepër cilësorë. Mbështetësja dhe ndenjësja duhet të jenë të veshura me material amortizues dhe të jenë të mbuluara me material rezistent, antibakterial, i padepërtushëm nga uji dhe praktik ndaj procesit të larjes. Lartësia e karriges duhet të jetë jo më të vogla se: Shpinorja 90 cm dhe ulësja 45 cm. Karriget duhet të jenë me aksesorë për bashkimin e tyre përbri njëra tjetrës sipas vendit dhe gjatësisë në rreshta.

8. F.Poltronë me dy poste:

Poltronë dyshe, konferte, me strukturë solide të veshur me material amortizues. Ulësja dhe mbështetësja duhet të jenë të veshura me material rezistent, antibakterial, i padepërtushëm nga uji dhe praktik ndaj procesit të larjes. Gjithashtu, poltrona duhet të jetë e pajisur me mbështetëse për krahët. Përmasat duhet të jenë jo më të vogla se 160x80x90 cm

9. F.Tavolinë pune specialisti 1:

Tavolina duhet të jetë me material laminant me bordure të plastifikuar me trashësi 2.5 cm. Dimensioi (120 x 65 x h75) cm. Ajo do të ketë një strukturë të përbërë nga dy panele anësorë me përmasa 70x75x2.5 cm, të cilat mbajnë edhe peshën e mobiljes dhe janë të lidhura nga një panel në pjesën ballore të saj me përmasa 110x50x2.5 cm. Syprina do të ketë një të çarë rrethore, të mbuluar me aksesorin

përkatës, me diametër 5 cm për kalimin e kablllobe të kompiuterit. Takimi në tokë me distanciatore plastikë kundër lagështirës.

10. F.Tavolinë pune specialisti 2:

Tavolina duhet të jetë me material laminant me bordure te plastifikuar me trashësi 2.5 cm. Dimensioni (140 x 80 x h75) cm. Ajo do të ketë një strukturë të përbërë nga dy panele anësorë me përmasa 70x75x2.5 cm, të cilat mbajnë edhe peshën e mobiljes dhe janë të lidhura nga një panel në pjesën ballore të saj me përmasa 110x50x2.5 cm. Syprina do të ketë një të çarë rrethore, të mbuluar me aksesoren përkatës, me diametër 5 cm për kalimin e kablllobe të kompiuterit. Takimi në tokë me distanciatore plastikë kundër lagështirës.

11. F.Tavolinë pune me kënd:

Tavolina duhet të jetë me material laminant me bordure te plastifikuar me trashësi 2.5 cm. Ajo do të ketë një strukturë të përbërë nga dy pjesë. Pjesa kryesore, me përmasa 160x80xh75 cm, është e ndërtuar me panele anësorë të lidhura midis tyre në vertikalisht nga një panel lidhës , të cilat mbajnë edhe peshën e mobiljes. Pjesa e këndit, është me përmasa 80x60xh75 dhe me material laminant me bordura të pastifikuara. Syprina do të ketë një të çarë rrethore, të mbuluar me aksesoren përkatës, me diametër 5 cm për kalimin e kablllobe të kompiuterit. Takimi në tokë me distanciatore plastikë kundër lagështirës.

12. F.Tavolinë pune drejtuesi:

Tavolina duhet të jetë me material laminant me bordure te plastifikuar me trashësi 2.5 cm. Ajo do të ketë një strukturë të përbërë nga dy pjesë. Pjesa kryesore, me përmasa 180x90xh75 cm, është e ndërtuar me panele anësorë të lidhura midis tyre në vertikalisht nga një panel lidhës , të cilat mbajnë edhe peshën e mobiljes. Pjesa e këndit, është me përmasa 180x50xh65 dhe me material laminant me bordura të pastifikuara. Kjo pjesë ndërfutet tek pjesa kryesore, falë lartësisë më të ulët. Syprina do të ketë një të çarë rrethore, të mbuluar me aksesoren përkatës, me diametër 5 cm për kalimin e kablllobe të kompiuterit. Takimi në tokë me distanciatore plastikë kundër lagështirës.

13. F.Tavolinë mbledhjeje për 4 vende:

Tavolina duhet të jetë me material laminant me bordurë të plastifikuar me trashësi 2.5 cm, dhe me dimensione jo më të vogla se 200x100xh75cm. Ajo do të ketë një strukturë të përshtatshme për të mundësuar akomodimin në dy brinjët e gjata të saj të 4 personave. Takimi në tokë me distanciatore plastikë kundër lagështirës.

14. F.Tavolinë mbledhjeje për 6 vende:

Tavolina duhet të jetë me material laminant me bordurë të plastifikuar me trashësi 2.5cm, dhe me dimensione jo më të vogla se 240x100xh75 cm. Ajo do të ketë një strukturë të përshtatshme për të mundësuar akomodimin në dy brinjët e gjata të saj të 6 personave. Takimi në tokë me distanciatore plastikë kundër lagështirës.

15. F.Tavolinë për katedër

Tavolina për akomodimin e dy personave, duhet të jetë me material laminant me bordure te plastifikuar me trashësi 2.5 cm. Dimensioni (140 x 70 x h75) cm. Ajo do të ketë një strukturë të përbërë nga dy panele anësorë me përmasa 70x75x2.5 cm, të cilat mbajnë edhe peshën e mobiljes dhe janë të lidhura nga një panel në pjesën ballore të saj me përmasa 110x50x2.5 cm. Syprina do të ketë një të çarë rrethore, të mbuluar me aksesoren përkatës, me diametër 5 cm për kalimin e kablllobe të kompiuterit. Takimi në tokë me distanciatore plastikë kundër lagështirës.

16. F.V. Foltore:

Foltorja do të ndërtohet me material laminant me bordura të plastifikuara, me trashësi 2.5 cm. Ajo do të jetë e përbërë nga pjesa e foltores, një mobilje e mbyllur nga të treja anët dhe e hapur nga ana e folësit, me syprinë të pjerrët me kënd jo më të madh se 30 gradë dhe aksesore për mbajtjen e

dokumentacionit. Kjo foltore do të ketë edhe bazamentin, me përmasa (60x47xh110cm) e cila do të vendoset mbi podium. Në fundin e saj do të pajiset me tapa fundore të cilat do të shërbejnë për nivelimin e saj.

17. F.Tavolinë ngrënieje për dhomë stafi:

Tavolina duhet të jetë me material laminant me bordurë të plastifikuar me trashësi 2.5 cm., dhe me dimensione 160x80xh75 cm. Ajo do të ketë një strukturë të përshtatshme për të mundësuar akomodimin në dy brinjët e gjata të saj të 6 personave. Takimi në tokë me distanciatore plastikë kundër lagështirës.

18. F.Tavolinë e vogël mes

Tavolina me dimensione 80x40x h40 cm, duhet të ketë syprinën me material laminant me bordurë të plastifikuar me trashësi 2.5 cm, dhe strukturë me skelet metalik, tubolar me seksion katror me sipërfaqe të lyster me proces elektrolitik. Takimi në tokë me distanciatore plastikë kundër lagështirë

19. F.Karrocë me rrota:

Karrelë për transport pajisjesh mjeksore, e kornizuar me strukturë metalike tubulare e paoksidueshme, me 4 rrota dy prej të cilave me sistem frenimi, e ndarë në 3 kate, me syprine metalike inoks në secilin kat .

20. F.Komodina me 3 sirtare:

Komodinë me përmasa jo më të vogla se (42 x 55x 55 cm) me tre sirtarë, të paisur me doreza metalike të kromuara dhe çelës. Materiali i komodinës do të jetë laminant me trashësi 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Komodina duhet të jetë rezistente kundrejt goditjeve dhe e pajisur me rrota plastike.

21. F.V Mobilje kuzhine me lavapjatë :

Mobilja me lavapjatë duhet ndërtuar si një strukturë më vete, me përmasa jo më të vogla se (90x60xh85cm), me material laminant me trashësi jo më të vogël se 1.6 cm dhe bordurë të plastifikuar. Shpinorja e mobiljes duhet të jetë e veshur me material laminant me trashësi 0.3 cm. Syprina duhet të jetë me material rezistues ndaj lagështirës të cilësisë së lartë laminat i plastifikuar (ABS) dhe trashësi 4-5 cm, i cili siguron qëndrueshmëri të gjatë. Mbi këtë syprinë është i inkorporuar lavapjati me material inoksi me një gropë dhe një vend për kullimin e enëve të kuzhinës. Në lavapjatë duhet të jetë montuar dhe grupi i miksimit të ujit. Poshtë lavapjatit, duhet të ketë një dollap me dy kanate me doreze metalike ngjyre gri mat, ku në njërin prej tyre duhet të ketë inkorporuar koshin e mbeturinave me material plastik me kapak të lëvizshëm. Struktura duhet të ketë katër këmbë plastike me lartësi 10 cm, të regjistrueshme, dhe të mbuluara me fashetë lineare.

22. F.V Mobilje kuzhine pa lavapjatë :

Mobilja pa lavapjatë duhet ndërtuar si një strukturë më vete, me përmasa jo më të vogla se (90x60xh85cm), me material laminant me trashësi jo më të vogël se 1.6 cm dhe bordurë të plastifikuar. Shpinorja e mobiljes duhet të jetë e veshur me material laminant me trashësi 0.3 cm. Syprina duhet të jetë me material rezistues ndaj lagështirës të cilësisë së lartë laminat i plastifikuar (ABS) dhe trashësi 4-5 cm, i cili siguron qëndrueshmëri të gjatë. Mobilja, duhet të ketë një dollap me dy kanate me material laminant, me bordurë të plastifikuar, me doreze metalike ngjyre gri mat, të ndarë horizontalisht në dy hapsira të barabarta. Struktura duhet të ketë katër këmbë plastike me lartësi 10 cm, të regjistrueshme, dhe të mbuluara me fashetë lineare.

23. F.Bibliotekë etazher:

Biblioteka etazher do të ketë përmasa jo më të vogla se 90x45xh60 me material laminant me trashësi jo më të vogël se 2.5 cm, me bordurë të plastifikuar. Mobilja duhet të jetë e ndarë vertikalisht në 2 hapsira dhe vertikalisht në 4 hapsira. Shpinorja e mobiljes duhet të jetë e veshur me material laminant,

me trashësi jo më të vogël se 0.3 cm. Këmbët duhet të jene metalike të veshura me plastikë me lartesi jo më të vogël se 5 cm.

24. F.Rafte element i hapur:

Raft me element të hapur me përmasa jo më të vogël se (90x45xh200cm) me material laminant me trashësi jo më të vogël se 2.5 cm, me bordurë të plastifikuar. Mobilja duhet të jetë e ndarë vertikalish në 5 hapsira. Shpinorja e mobiljes duhet të jetë e veshur me material laminant, me trashësi jo më të vogël se 0.3 cm. Këmbët duhet të jene metalike të veshura me plastikë me lartesi jo më të vogël se 5 cm.

25. F.Rafte element gjysem i hapur:

Element gjysem i hapur për arkivim dokumentacioni jo më të vogël se (90x45xh200cm) me material laminant trashësi jo më të vogël se 2.5 cm, me bordurë të plastifikuar. Mobilja duhet të ketë dy kanata në pjesën e poshtme me celës. I gjithë rafti duhet të jete i ndarë vertikalish në 5 hapsira nga të cilat dy të poshtëmet do të jenë brenda hapsirës së mbyllur. Shpinorja e mobiljes duhet të jetë e veshur me material laminant, me trashësi jo më të vogël se 0.3 cm. Këmbët duhet të jene metalike me lartesi jo më të vogël se 5 cm.

26. F.Raft i mbyllur metalik:

Raft me strukturë metalike, me dimensione (90x45xh200cm) me dy dyer të rreshqitëshme dhe me bravë. Mobilja duhet të ketë horizontalitet, 5 hapsira ndarjeje në brendësi. Rafti duhet të jetë i lyer me bojë nëpërmjet procesit elektrostatik. Takimi me tokën do të bëhet nëpërmjet këmbëve metalike, jo më të vogla se 5 cm.

27. F.V. Raft i hapur metalik:

Raft me strukturë metalike prej çeliku special dhe të galvanizuar, me dimensione (100x45xh200cm). Mobilja duhet të ketë horizontalitet, 5 hapsira ndarjeje në brendësi, të aksesueshme nga të dyja anët. Peshëmbajtja për një sergjën duhet të jetë 150 kg, me ngarkesë uniformisht të shpërndarë. Mënyra e bashkimit të pjesëve të mobiljes do të bëhet me bulona dhe dado. bashkimi duhet të jetë i tillë që mobilia të mos pësojë lëkundje apo palosje.

28. F.V Reception një post :

Reception për një post, për sekretarinë e Rektoratit, me dy nivele, jo më të vogël se (140x70xh75cm) me lartësi të nivelit të dytë jo më të vogël se 110 cm, me gjerësi të syprinës jo më të vogël se 25 cm, i cili do të jetë në anën e vizitorit. Mobilja duhet të jetë e hapur nga ana e operatorit për pozicionim e këmbëve dhe vendosjen e një sirtarjere. Materiali do të jete laminant me trashësi jo më të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Syprina e dyte duhet të jetë me material xham i temperuar dhe me anë të lëmuara dhe duhet të kapet me të parën me aksesor mbajtës metalik të nikeluar. Në brendësi, receptioni do të ketë 3 komodina me nga 3 sirtarë, me përmasa jo më të vogla se (42x55xh55 cm) me material laminant me trashësi jo më të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota.

29. F.V Reception për tre poste :

Reception për tre poste, për sekretarinë e Fakultetit të Infermierisë, me dy nivele, jo më të vogël se (390x60x h75cm) me lartësi të nivelit të dyte jo më të vogël se 110 cm, me gjerësi jo më të vogël se 25 cm, i cili do të jete në anën e vizitorit. Mobilja duhet të jete e hapur nga ana e operatorit për pozicionim e këmbëve dhe vendosjen e një sirtarjere. Materiali do të jete laminant me trashësi jo më të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Syprina e dyte duhet të jetë me material xham i temperuar dhe me anë të lëmuara dhe duhet të kapet me të parën me aksesor mbajtës metalik të nikeluar. Në brendësi, receptioni do të ketë 3 komodina me nga 3 sirtarë, me përmasa jo më të vogla se (42x55xh55 cm) me material laminant me trashësi jo më të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota.

30. F.Varëse Rrobash “prift” :

Varëse Rrobash “prift” e përbërë me 5 varëse, me strukturë plastike dhe ngjyrë të errët, me vend në pjesën e poshtme të strukturës për vendosjen e cadrave.

31. F.V. Tabelë e zezë shkrimi vertikale:

Përmasat: 180x120 cm. Për përdorim në auditor, e errët dhe e kornizuar me material rezistent; perberja plastike. Të jenë e përshtatshme për shkrim me lapustila jo permanente dhe gjithashtu të jetë e pajisur me aksesoret e pozicionimit të materialeve grafike.

Hartimi i listës së plotë të pajisjeve të mobilimit dhe sasi të përkatëse, të specifikuar edhe sipas pozicionimit

Për të bërë të mundur shpërndarjen e mobilimit në objektet dhe hapsirat përkatëse, listimi i pajisjeve të mobilimit është bërë duke i grupuar ato sipas emrit të Institucionit. Kjo do të lehtësojë edhe kontabilizimin e tyre pasi ato të magazinohen dhe shpërndahen. Ky material është rishikuar pasi janë marrë edhe ofertat e tregut në lidhje me precaktimin e cmimit njësi të zerave të preventivit, duke përshtatur sasitë në varësi të fondit limit dhe është gati për tenderim. Në vijim është lista e mobilimit ku janë specifikuar vendndodhja dhe sasia e tyre.

Nr.	Emertimi i Pajisjeve të Mobilimit	Njesia	Sasia Total		
1 .Fakulteti I Shkencave Mjekësore Teknike					
Sekretaria Mesimore dhe Dekanati					
1	F. Karrige - Poltronë për vend pune drejtuesi	copë	3		
2	F. Karrige-Poltronë për vend pune specialisti	copë	9		
3	F. Karrige për tavolinë mbledhjeje	copë	10		
4	F. Karrige e thjeshtë	copë	8		
5	F. Tavolinë pune specialisti 2	copë	6		
6	F. Tavolinë pune me kënd	copë	2		
7	F. Tavolinë pune drejtuesi	copë	1		
8	F. Tavolinë mbledhjeje për 4 vende	copë	1		
9	F. Tavolinë mbledhjeje për 6 vende	copë	1		
10	F. Komodina me 3 sirtare	copë	9		
11	F. Bibliotekë etazher	copë	2		
12	F. Raft element i hapur	copë	6		
13	F. Raft Element gjysem i hapur	copë	10		
14	F.V. Raft i hapur metalik	copë	20		
15	F.V Reception për tre poste	copë	1		
16	F. Varëse Rrobash "prift"	copë	7		

2. Fakulteti Mjekësisë					
Administrata dhe auditori i Departamentit të Kirurgjisë					
1	F. Karrige - Poltronë për vend pune drejtuesi	copë	3		
2	F. Karrige-Poltronë për vend pune specialisti	copë	2		
3	F. Karrige për tavolinë mbledhjeje	copë	14		
4	F.V. Poltronë për auditor	copë	120		
5	F. Tavolinë pune me kënd	copë	3		
6	F. Tavolinë mbledhjeje për 4 vende	copë	2		
7	F. Tavolinë mbledhjeje për 6 vende	copë	1		
8	F. Tavolinë për katedër	copë	1		
9	F.V. Foltore	copë	1		
10	F. Komodina me 3 sirtare	copë	4		
11	F. Bibliotekë etazher	copë	2		
12	F. Rafte element i hapur	copë	1		
13	F. Rafte Element gjysem i hapur	copë	3		
14	F. Varëse Rrobash "prift"	copë	5		
15	F.V. Tabelë e zezë shkrimi vertikale	copë	1		
3. Rektorati i Universitetit të Mjekësisë					
Administrata					
1	F. Karrige - Poltronë për vend pune drejtuesi	copë	13		
2	F. Karrige-Poltronë për vend pune specialisti	copë	18		
3	F. Karrige e thjeshtë	copë	10		
4	F. Poltronë me dy poste	copë	1		
5	F. Tavolinë pune specialisti 1	copë	6		
6	F. Tavolinë pune specialisti 2	copë	13		
7	F. Tavolinë pune me kënd	copë	10		
8	F. Tavolinë pune drejtuesi	copë	3		
9	F. Tavolinë ngrënieje për dhomë stafi	copë	2		
10	F. Tavolinë e vogël mesi	copë	1		
11	F. Komodina me 3 sirtare	copë	30		
12	F.V Mobilje kuzhine me lavapjatë	copë	1		
13	F.V Mobilje kuzhine pa lavapjatë	copë	1		
14	F. Biblioteke etazher	copë	6		
15	F. Rafte element i hapur	copë	10		
16	F. Rafte Element gjysem i hapur	copë	17		
17	F.V. Raft i hapur metalik	copë	15		
18	F.V Reception një post	copë	1		
19	F. Varëse Rrobash "prift"	copë	11		

4. Fakulteti I Mjekësisë Dentare					
Sekretaria Mesimore, Kabineti i Specializaneve, Korridori i katit të katërt, Auditori dhe Magazina					
1	F. Stol metalik për pritje në holli	copë	4		
2	F. Karrige-Poltronë për vend pune specialisti	copë	5		
3	F.V. Karrige për auditor	copë	64		
4	F. Tavolinë pune specialisti 2	copë	3		
5	F. Tavolinë për katedër	copë	1		
6	F.V. Foltore	copë	1		
7	F. Karrocë me rrota	copë	6		
8	F. Komodina me 3 sirtare	copë	4		
9	F. Raft element i hapur	copë	1		
10	F. Raft Element gjysem i hapur	copë	2		
11	F. Raft i mbyllur metalik	copë	3		
12	F.V. Raft i hapur metalik	copë	6		
13	F. Varëse Rrobash "prift"	copë	9		
14	F.V. Tabelë e zezë shkrimi vertikale	copë	1		

